KOSOVA
që duam

KONGRESI I PARË NACIONAL
“KOSOVA QË NE DUAM”

SIGURI SOCIALE
ZHVILLIM EKONOMIK
PUNË DHE JETË TË DINJITETSHME

PËRKRAHUR NGA: FRIEDRICH EBERT STIFTUNG

FRIEDRICH EBERT STIFTUNG
Büro Kosovo

Telefoni:
+383 38 22 11 08

/FESPrishtina/
www.fes-kosovo.org



//

KOSOVA QË NE DUAM

Siguri Sociale

Zhvillim Ekonomik

Punë dhe Jetë të Dinjitetshme

Lexues/e i/e nderuar

Dokumenti në vazhdim përmban një përmbledhje të ideve dhe feedback që janë diskutuar në fillimin e ngjarjes platformë "**Kosova që duam**", duke përfshirë edhe punën e bërë gjatë sesioneve të punës në grupe në dhomat e mendimit për pesë fushat kyçe, organizuar më 23.05.2018.

Friedrich Ebert Stiftung (FES) në bashkëpunim me partnerët e vet – **MDA** (Management Development Associates), **Kolegji Riinvest** dhe **Instituti**, **IKS** (Iniciativa Kosovare për Stabilitet), **Kolegji Heimerer**, **GAP** dhe **Demokracia +** kanë qenë nikoqirë të Kongresit të parë Nacional, të këtij lloji që mbante titullin "Kosova që Ne Duam", datë 23 maj.

Më shumë se 200 pjesëmarrës, nga fusha dhe perspektiva të ndryshme, të cilët përfaqësonin më shumë se 100 organizata nga shoqëria civile, partitë, sindikatat, ekspertët dhe mediet, kishin ardhur nga pjesë të ndryshme të Kosovës dhe mbledhur për të këmbyer pikëpamjet e tyre, idetë dhe dëshirat për një Kosovë ndryshe, që ata duan.

Sesioni i hapjes në fillim të ngjarjes e paraqiti bazën dhe shpjegoi se përse FES-i e kishte inicuar këtë platformë duke bërë thirrje dhe duke i ftuar të gjithë qytetarët e Kosovës të cilët duan që zëri i tyre të dëgjohet dhe të sugjerojnë idetë për atë se si mund të punojmë bashkërisht në adresimin e problemeve kryesore me të cilat po ballafaqohet shoqëria e Kosovës, si bie fjala: siguria sociale, zhvillimi ekonomik dhe punësimi si dhe një punë e denjë dhe kushte jetësore.

Konteksti i ngjarjes dhe metodat tona të punës do të paraqiten, e më pas në mënyrë kritike do të rishikohen duke përgatitur një përmbledhje nga secili grup punues që ka punuar në dhomën e mendimeve. Në fund, janë paraqitur konkluzionet dhe rekomandimet për hapat e ardhshëm.

PËRMBAJTJA

Komente paraprake
MODELI EKONOMIK DHE SOCIAL EVROPIAN (EESM) 8

KONCEPTUALIZIMI I PLATFORMËS
– PËRSE KJO DHE PËRSE TANI? 10

STRUKTURA E PUNËS 12

SESIONI I HAPJES-SIGURON BAZËN DHE QËLLIMET 13

DHOMAT PARALELE TË TË MENDUARIT 16

PUNA NË DHOMAT PARALELE TË MENDIMIT 17
Dhoma e Mendimit 1: 18
Dhoma e Mendimit 2: 29
Dhoma e Mendimit 3: 33
Dhoma e Mendimit 4: 39
Dhoma e Mendimit 5: 45

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME PËR PUNËN E MËTEJSHME 54

PJESËMARRËSIT 56

Komente paraprake

MODELI EKONOMIK DHE SOCIAL EVROPIAN (EESM)

Kosova është shteti më ri në Evropë. Por, Evropa tashmë e ka një traditë të vjetër në zhvillimin e sistemeve të sigurisë sociale dhe të udhëzimeve. Ato po ashtu janë pjesë e "Acquis Communautaire" të Bashkimit Evropian. Prandaj, së pari Kosova duhet t'i arrijë standardet minimale në rrafshin ekonomik, social dhe mjedisor, në mënyrë që të plotësohen parakushtet për anëtarësim në BE. Këto, veç gjendjes së rëndë socio-ekonomike të popullatës së Kosovës paraqesin një bazë për lëvizje qytetare e cila ka filluar me Kongresin e parë Nacional, në maj 2018, me titullin "Kosova që Ne Duam!".

PJESËMARRJA SI ÇELËS PËR NJË DEMOKRACI STABILE

Akoma, shumica e elitës politike të Kosovës nuk e kuptojnë menaxhimin e demokracisë së gjallë. Siç e ka përmendur edhe Veton Surroi, një anëtar i respektuar i shoqërisë civile në Kosovë, në njërën prej ngjarjeve të organizuara nga FES-i se, Kosova duhet të kaloj nga "kultura e luftës në kulturën e paqes". "Kultura e luftës" është e bazuar në strukturat kierarkike të një luftanije armiqësore dhe që vepron në bazë të urdhrave. Por, si shtet i ardhshëm anëtar i Bashkimit Evropian, Kosova duhet të zhvilloj një "kulturë të paqes" të bazuar në dialog, respekt për opinionet tjera dhe për secilin qytetar. Dialogu ka nevojë për kompetencë nga të dyja palët si dhe bashkëpërgjegjësi. Meqë të dyja palët – politikanët dhe qytetarët – mund të zhvillojnë një shtet funksional dhe demokratik përmes një përgjegjësie dhe respekti të përbashkët.

BASHKËPËRGJEGJËSIA – NJË SINONIM PËR NJË RRUGË DYKAHËSHE ME KONTRIBUTE DHE TË DREJTA

Një marrëdhënie në mes të qytetarëve duhet të zhvillohet dhe duhet të jetë e tillë dhe e bazuar në respekt dhe besim – nga të dyja anët. Qytetarët e cili do shteti kanë të drejtë për një mbështetje bazike në shumë aspekte të jetës si në, arsim, siguri sociale, korniza ligjore, etj. Por, ata po ashtu kanë obligime ndaj shtetit të tyre. Tatimet dhe kontributet tjera për sistemet e solidaritetit janë e vetmja mënyrë për realizimin e të drejtave të tyre në mënyrë të duhur.



NjË ZË DHE KOMPETENCË E SHUMËFISHTË E QYTETARËVE – PARAKUSHT I NDRYSHIMEVE

Një zhvillim i qëndrueshëm i ekonomisë, mirëqenies dhe sigurisë sociale mungon që nga themelimi i shtetit të ri. Përkundër mijëra protestave dhe këshillave edhe më kompetente nga shoqëria civile – duke filluar nga baza, këshillat e deri te sindikatat – duket se është e domosdoshme që politika të detyrohet për të dëgjuar më shumë se një zë dhe përgjigje miqësore. Të gjitha organizatat dhe grupet në Kosovë ftohen që të zhvillojnë një zë të përbashkët në bazë të përvojave dhe kompetencave të tyre të pasura. Zëri i qytetarëve ka nevojë të dëgjohet!

FILLIMI I I NJË LËVIZJEJE GJITHËPËRFSHIRËSE E FASILITUAR NGA SHUMË PARTNERË KOSOVAR DHE NGA FONDACIONI FRIEDRICH EBERT (FES)

Shumë organizata dhe ekspertë janë në rolin e fasilitatorëve bashkë me Fondacionin Friedrich Ebert (FES) për zhvillimin e analizave kompetente, të propozimeve për zgjidhjet me perspektivë të mirë dhe strategji për të hyrë në pjesëmarrje demokratike të shoqërisë civile në debatet e ardhme për politikat dhe vendimet. Kjo është e mundur vetëm për shkakun se ka shumë partnerë të gatshëm nga shoqëria civile, sindikata dhe partitë. Ata të gjithë kanë qëllime dhe funksione të ndryshme në shoqërinë tonë, por ata janë të lidhur me njëri-tjetrin në një qëllim të përbashkët: “Kosova që duam” duhet të jetë një shtet i cili siguron zhvillim ekonomik dhe punë të denjë si dhe siguri sociale dhe një kornizë ligjore funksionale.

Frank Hantke
Friedrich-Ebert-Stiftung
Zyra në Kosovë Drejtor

https://www.fes-kosovo.org/e/national-congress-the-kosovo-we-want-1/



KONCEPTUALIZIMI I PLATFORMËS – PËRSE KJO DHE PËRSE TANI?

Pas disa muajsh hulumtimi, FES-i erdhi në përfundim se ekziston nevoja për një platformë qytetare ku do të veheshin në pah sfidat kryesore të shoqërisë në Kosovë dhe të adresoheshin përmes punës me pjesëmarrje të organizatave nga shoqëria civile, ekspertët dhe politikanët.

Frank Hantke, Drejtor i Zyrës së FES-it në Kosovë, në fjalimin e tij hyrës shpjegoi se ndonëse tashmë ekziston një kompetencë e lartë në shoqërinë civile të Kosovës, situata reale sociale, ekonomike dhe politike nuk e reflekton këtë kompetencë. Prandaj, sipas z. Hantke, një formë e re e dilaogut në mes të qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre është e nevojshme në rrafshin e politikave, duke e synuar arritjen e një **zëri të fuqishëm e të përbashkët** për një zhvillim social, ekonomik dhe demokratik **që janë shqetësimi kryesor i qytetarëve të Kosovës**. Në mënyrë metaforike z. Hantke i sheh aktorët nga shoqëria civile si të ishin **perla** të cilat duhet **të lidhen në një varg të përbashkët:** propozimet për një Kosovë më të mirë, që qytetarët duan.


Për këtë arsye, pas një procesi të konsiderueshëm reflektues në mesin e ekipit të FES-it, u identifikuan pesë fusha kryesore për një Kosovë më të mirë për të udhëhequr me punën në vazhdim të FES-it dhe të partnerëve të vet gjatë muajve të ardhshëm duke e shfrytëzuar qasjen e “Dhomës së mendimit“ e cila tashmë ishte


http://library.fes.de/pdf-files/wiso/12058.pdf

përdorur nga FES-i në kontekstin gjerman.

"**Dhoma e mendimit** (**hapësira**)/*Denkraum*" është një koncept inovativ në menaxhimin e projekteve, i dizajnuar me idenë e krijimit të hapësirës për një mendim të hapur dhe njëkohësisht një proces të mendimit të strukturuar lidhur me vendimet e rëndësishme për politikat e shoqërisë. Përfaqësuesit nga shoqëria civile, politikanët, ekspertët dhe qytetarët janë ftuar për të ofruar guximin e tyre dhe që bashkë "përtej punëve të veta ditore", të mendojnë dhe të balancojnë konceptet dhe pikëpamjet e tyre profesionale, me qasje politike, zgjidhje të mundshme dhe nevoja të qytetarëve.

Të pesë "Dhomat e mendimit" janë dizajnuar për të akomoduar diskutime dinamike nga grupet punuese gjatë gjithë vitit, duke rezultuar me një udhërrëfyes të qartë dhe një plan veprim të përbashkët, të nënshkruar prej gjithë pjesëmarrësve, si një përkushtim i përbashkët për të punuar për një Kosovë më të mirë që ne gjithë duam.





STRUKTURA E PUNËS

Puna e Kongresit ishte strukturuar në mënyrë që secila fushë i ka akomoduar pjesëmarrësit e interesuar në “Dhomat e mendimit” në mënyrë të lirshme dhe në fushën/punën për të cilën ishin të interesuar.

Në disa prej dhomave të mendimit, pjesëmarrësit ishin ndarë në nëngrupe, pasi fasilitatorët dhe ekspertët në terren e panë të arsyeshme që të mundësohen diskutime më të thella për temat specifike. Detyra e fasilitatorëve në dhomat e mendimit ishte që të udhëheqin pjesëmarrësit në identifikimin e problemeve kyçe për secilën fushë, dhe të përkrahin qasjen se zgjidhjet duhet të gjenden duke e përdor qasjen nga poshtë-lart. Raporti në vazhdim përmban një përshkrim të hollësishëm, por të përmbledhur për secilën prej fushave ku janë nënvizuar çështjet, numri i rekomandimeve, prioritetet, dhe afatet kohore të propozuara për punën e ardhshme të secilit grup.

SESIONI I HAPJES-SIGURON BAZËN DHE QËLLIMET

Sesioni hapjes së Kongresit përfshinte një video storje në kohëzgjatje prej shtatë minutave, ku njerëzit ishin intervistuar nga secila fushë e përmendur dhe aty ishin paraqitur sfidat dhe çështjet reale. Sektori i shëndetësisë është paraqitur me mungesa të medikamenteve përkatëse për pacientë dhe radhët e gjata duke pritur trajtimin e nevojshëm. Kushtet në spital ishin më shumë se të këqija dhe kishte pacientë të cilët flisnin për mungesë të cilësisë dhe kujdesit të duhur. Një fushë tjetër tregon se si punëtorët janë të rrezikuar duke punuar pa ndonjë mbrojtje fizike, meqenëse atyre nuk u janë siguruar pajisjet e duhura për punë në sektorin e ndërtimtarisë. Po ashtu, se si ata nuk kanë asnjë kontratë pune dhe se nuk janë në gjendje të flasin më shumë për shkak të frikës se mos humbin vendin e punës, sepse ata mund të zëvendësohen pothuajse menjëherë. Një pamje tjetër tregon shtrimin e rrugëve, e që nuk është bërë si duhet, dhe ndonëse qytetarët janë ankuar, asgjë nuk është bërë lidhur me këtë.

Videoja ka shërbyer si vëmendje se në çka duhet të fokusohet shoqëria civile, dhe për presionin e nevojshëm ndaj qeverisë dhe institucioneve tjera për adresimin e këtyre problemeve në mënyrë efektive përmes krijimit dhe pjesëmarrjes në proceset e zhvillimit të politikave.



Pas video storjes, e cila kishte një efekt befasues në mesin e pjesëmarrësve, ndërsa qëllimi ishte që storja t'i motivojë ata për t'u angazhuar dhe gjetur zgjidhjet për problemet e paraqitura. Fjalimi hyrës i qe besuar një vajze 16 vjeçare, fituese e një çmimi të veçant për shkathtësi në programim bashkë me të ishte edhe babai i saj që është kolonel në Policinë e Kosovës dhe nëna e saj e papunë por e përkushtuar, e cila kujdeset për gjashtë fëmijët e saj.

Që të tre kërkuan nga publiku që të bëhen bashkë dhe të "mendojnë" për gjetjen e zgjidhjeve për gjeneratat e reja, por po ashtu edhe për zyrtarët e shërbimeve publike, policët, gratë,

https://www.facebook.com/FESPrishtina/videos/2120260121524949/



Kongresi e vazhdoi punën përmes prezantimit të dhënë nga MDA për një model të mundshëm të zhvillimit të qëndrueshëm për Kosovën. Vizualizimi i metadatave për trendet e zhvillimit ekonomik të sektorëve në Evropë, mundësinë për modelin e zhvillimit të Kosovës dhe të komunave të saj, të filtruara sipas sektorëve dhe profesioneve, me synim të përkrahjes së një zhvillimi sektoral të bazuar në modelin e zhvillimit për Kosovën dhe nevojën për një vizion afatgjatë për mundësitë e zhvillimit të Kosovës.



//
DHOMAT PARALELE TË TË MENDUARIT

Dhoma 1:

ARSIMI PËR PUNËSIM DHE PËR ZHVILLIM

Fasilituar nga **Mevlyde Hyseni, FES**
dhe **Bardha Qirezi, Kolegji Riinvest**



Dhoma 2:

AKTIVIZMI QYTETAR PËR QEVERISJE TË MIRË


Fasilituar nga **Besa Kabashi-Ramaj FES**
dhe **Jetmir Bakija (Demokracia +)**



Dhoma 3:

ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM EKONOMIK DHE KRIJIMI I VENDEVE TË PUNËS


Fasilituar nga **Besa Luzha, FES**
dhe **Rinor Gjonbalaj, MDA**



Dhoma 4:

PUNA DHE JETA E DINJITETSHME PËRMES DIALOGUT SOCIAL


Fasilituar nga **Alush Berisha, FES**
dhe **Jeton Mehmeti, GAP**



Dhoma 5

MIRËQENIA SOCIALE DHE POLITIKAT SHËNDETËSORE

Fasilituar nga **Antoneta Coli, FES**
dhe **Florina Duli, IKS** (mirëqenia sociale)
dhe **Hana Xhemajli, FES &**
Ilir Hoxha, Heimerer
(Politikat Shëndetësore)



PUNA NË DHOMAT PARALELE TË MENDIMIT

Grupet punuese paralele u organizuan në dy sesione të njëpasnjëshme. Sesioni i parë shërbeu më shumë si një pjesë hyrëse për të gjithë partnerët dhe fushat e tyre të interesit, përvojat e tyre në këto fusha dhe çfarë shpresojnë ata se do të sjell kjo iniciativë në shoqëri.

Ndërsa, sesioni i dytë përfshinte një diskutim më të hollësishëm drejt identifikimit të problemeve kryesore në fushat specifike dhe duke e lejuar mundësinë për konsenzus për atë që grupi e konsideronte të jetë një prioritet për qytetarët. Puna e pas-kongresit për secilin grup përfshinë një vendim të përbashkët përkitazi me atë se cilët duhet të jenë hapat e parë në procesin e adresimit të problemeve dhe të përpjekjeve për gjetjen e zgjidhjeve.

Me të përfunduar dhomat e mendimit punën e tyre, ekipet më pas e kanë bërë prezantimin e gjetjeve në sesionin plenar të kongresit, në mënyrë që të gjithë të përfitonin nga idetë e paraqitura, zgjidhjet dhe mënyrat më të mira për të punuar. Pas ngjarjes, ekipi i FES-it dhe partnerët i kanë mbledhur të gjitha shënimet nga raportuesit, dhe e kanë kryer një analizë tematike me qëllim të kontekstualizimit më të mirë të narrativës dhe identifikimit të çfarëdo teme të shfaqur, si dhe përgatitjen e terrenit për punën e ardhshme.







Dhoma e Mendimit 1:

ARSIMIM PËR PUNËSIM DHE RRITJE

Fasilituar nga **Mevlyde Hyseni, FES**
dhe **Bardha Qirezi, Kolegji Riinvest**

Pjesëmarrësit **(36) të ndarë në tri nëngrupe**

a / Arsimi Parauniversitar
b / Trajnimi për Aftësim Profesional (TAP)
c / Arsimi i Lartë


Secila fushë kishte detyrën që shërbente për të identifikuar temat e shfaqura dhe problematike në secilin nëngrup, prioritetizimin e çështjeve dhe propozimin e intervenimeve (në këtë fazë të hershme të diskutimit). Fasilitatorët mblidhnin të dhëna për pjesëmarrësit, lidhjet me organizatën dhe projektet aktuale në fushën e arsimit me qëllim të shenjimit të projekteve aktuale dhe të aktorëve kyç në këtë sektor. (Shih shtojca 1. Lista e pjesëmarrësve)





MESAZHET E PËRGJITHSHME KRYESORE

- Arsimi i hershëm është vendimtar për një sukses afatgjatë
- Shkollat janë miqësore ndaj nxënësve dhe të qasshme për të gjithë
- Shkollat përkrahin mbarëvajtjen, zhvillimin e talentit dhe suksesin e nxënësve
- Arsimi zhvillon potencialin e nxënësit përmes metodologjive të ndryshme të mësimdhënies dhe vlerësimit
- Arsimi dhe hulumtimi shfrytëzojnë përparimin teknologjik dhe ekonomik
- Cilësia matet nga përvoja shkollore dhe suksesi i mësimnxënies
- Komunitetet tona i mbështesin nxënësit që janë në gjendje të vështirë ekonomike dhe nxënësit me nevoja të veçanta
- Mësimdhënësit tanë vazhdimisht mësojnë dhe zhvillohen
- Arsimi krijon lidhje me komunitetet dhe industrinë
- Arsimi ynë mundëson trajnime fleksibile dhe tranzicion për arsimim dhe punë të mëtejme
- Shkollat e shfrytëzojnë teknologjinë dixhitale për mësimnxënie



VEPRIMET KYÇE JANË DHËNË NË 5 KATEGORI KRYESORE:

Legjislacioni dhe politikat

- Puna me MASHT-in, ligjvënësit dhe aktorët kryesor për të përmirësuar legjislacionin dhe politikat e arsimit
- Sipas prioriteteve, nëngrupet do të mbështeten nga FES-i

Integrimi i agjendës

- Puna me faktorët kyç për integrimin e agjendës
- Kush bën çfarë dhe si mund t'i bashkërendojmë veprimet
- Kush do të merr një iniciativë të re që është propozuar këtu dhe si mund të ndihmojë FES-i

Hulumtimi

- Puna me institucionet hulumtuese për të prodhuar dhe ndarë hulumtime cilësore të nevojshme për sektorin.
- Mbështetje për ekipet hulumtuese që të prodhojnë hulumtimin e nevojshëm
- Hulumtimet aktuale të jenë të qasshme për publikun

Avokimi

- Puna me OJQ-të për të avokuar për Çështjet Kyçe
- Sipas çështjeve të përzgjedhet OJQ-ja për të marrë pjesë në dhomën e mendimit
- Debatet në TV
- Iniciativat tjera

Arsimi dhe iniciativat për trajnime

- Puna me aktorët kyç për të mbështetur Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional për Mësimdhënësit, Administratorët dhe Menaxherët
- Program trajnues për mësimdhënësit e institucioneve të arsimit të lartë
- Mbështetje për programet trajnuese në sektroin parauniversitar

GRUPET PUNUESE:

ARSIMI PARAUNIVERSITAR

Çështjet kryesore:

• Qasje e pamjaftueshme në edukimin parashkollor (1)
• Numër i vogël i çerdheve për fëmijë (Mungesa e çerdheve pengesë kryesore për punësimin e grave) (1)
• Pabarazia sipas lokacionit, lloji i shkollës dhe statusi etnik/social/i paaftësisë (1)
• Zhvillimi i mësimdhënësve (2,5)
• Kurrikula e ngarkuar (2)
• Mosha e vjetër e mësimdhënësve – politikat e pensionimit të parakohshëm (1)
• Mungesa/ose Vlerësimi joadekuat i performancës dhe Kritereve për avancim (Të gjithë mësimdhënësit, të mirë ose jo marrin pagë të njëjtë) (1)
• Mungesa e këshilltarëve pedagogjik (1)
• Zhvillimi individual/ talenti nuk përkrahet (2)
• Nuk ka orë mësimore jashtë orarit/ orë shtesë për nxënësit që ngecin prapa në mësime (1)
• Nevoja për një aktivizëm shoqëror për të thekësuar nevojat, problemet dhe sukseset në arsim
• Nevoja për zhvillimin e aktiviteteve ekstra-kurrikulare (1)
• Nevoja për zhvillimin e shkathtësive të buta (p.sh., kreativiteti, puna ekipore, zgjidhja e problemit, komunikimi, Shih: Projekti ASSET)
• Nevoja për monitorim të legjislacionit (1)
• Nevoja për vlerësimin e realizimit të kurrikulës





Intervenimet e mundshme

• Strategjia specifike për Arsimin parashkollor / edukimin e hershëm (1)
• Strategjia specifike për Përkrahjen e fëmijëve me paaftësi (1)
• Analiza për zhvendosjen e buxhetit në arsim (1)
• Trajnimi i mësimdhënësve (metodat e mësimdhënies, vlerësimet, zhvillimi i shkathtësive të buta, integrimi i kurrikulës) (2,5)
• Integrimi i kurrikulës (Balancimi i përmbajtjes me zhvillim të shkathtësive) (2,5)
• Analizimi i moshës së mësimdhënësve në arsimin parauniversitar (1)
• Zhvillimi i performancës dhe i politikave të avancimit (1)
• Orët mësimore shtesë dhe aktivitetet ekstrakurrikulare – udhëzime dhe nxitje (1)
• Fond për projekte të udhëhequra nga nxënësit/mësimdhënësit dhe prindërit (1)
• Aktivitete dhe mekanizma për orientim në karrierë
• Projekt fond për Strategjinë për përmirësimin e shkollave (1)
• Raport mbi pabarazinë
• Hulumtim për rininë e mjedisit rural



ARSIMI PROFESIONAL

Problemet kryesore të identifikuara:

• Programet arsimore për AP të harmonizohen me nevojat e tregut (përvojat e nxjerra nga industria dhe jo MASHT-i)
• Mungesa e materialeve për mësimdhënie dhe mësimnxënie dhe e pajisjeve
• Mungesa e reputacionit për shkak të kulturës shkollore, cilësia e mësimdhënësve dhe perceptimi mbi rëndësinë dhe cilësinë e gjimnazeve
• Metoda tradicionale të mësimdhënies. Nevojë urgjente për trajnim të mësimdhënësve për metodat e mësimdhënies
• Vizion i paqartë për arsimin e AP (1)
• Formulë joadekuate e financimit (1)
• Mungesa e orientimit në karrierë në shkollat e mesme të ulta
• Mungesa e bashkëpunimit me bizneset
• Mungesa/ose Vlerësim joadekuat i performancës dhe kritereve për avancim (Të gjithë mësimdhënësit, të mirë ose jo marrin pagë të njëjtë) (1)
• Stereotipe gjinore për profesionet e caktuara

Projektet e mundshme:

• Debatim për Ligjin mbi Arsimin e Lartë për arritjen e konsenzusit për çështjet kyçe me ofruesit e AL (1)
• Standardizimi i politikave të regjistrimit në institucionet e AL (1)
• Ri-dizajnimi i Udhëzimeve dhe i Manualit për Sigurimin e Cilësisë (1)
• Monitorimi i zbatimit të legjislacionit dhe i procesit të akreditimit: Projekt monitorues që realizohet me organizatat nga shoqëria civile (1)
• Projekt për hulumtimin e tregut (3)
• Zhvillimi për orientim në karrierë
• Aktivizimi i pjesëmarrjes së të rinjve për të fituar shkathtësi për debatim (5)
• Një numër debatesh për çështjet e arsimit që duhet të organizohen brenda një viti (dokumentet e politikave) (3,4)



Intervenimet e mundshme:

• Hulumtimi për analizim të tregut (3)
• Vlerësimi i formulës së financimit dhe buxhetit për arsimin e AP (3)
• Trajnim për mësimdhënësit (si më lart) (2,5)
• Fushata avokuese për përkrahjen e arsimit për AP / stereotipet e bazuara në gjini (2, 3)
• Zhvillim i vlerësimit të performancës dhe i politikave të avancimit (1)
• Projekt fond për Strategjinë për përmirësimin e shkollave (1)

GRUPI PUNUES PËR ARSIMIN E LARTË

Problemet kryesore të identifikuara:

• Mungesa e të dhënave dhe raporteve nga hulumtimet e tregut
• Zgjerimi i qasjes në AL dhe themelimi i shumë institucioneve të AL nuk kanë siguruar një zhvillim adekuat të cilësisë dhe hulumtimit
• Nuk ka një marrëveshje mes aktorëve kryesorë për Ligjin mbi Arsimin e Lartë (1)
• Probleme në monitorim, zbatim të legjislacionit dhe me pavarësinë e organeve rregullatore (1)
• Mungesa e Integritetit akademik (1)
• Mungesa në zhvillimin e stafit akademik (Marrja e doktoraturës nuk do të thotë se personi është i mirë në mësimdhënie)
• Mungesa e literaturës
• Politizimi i sindikatave studentore
• Planet mësimore kanë mungesë të strategjive për mësimdhënie dhe literaturë adekuate
• Minoritetet e kanë problem të futen në tregun e punës për shkak të shkathtësive gjuhësore
• Mungesa e bashkëpunimit dhe mbështetjes për studentët me nevoja të veçanta





Trajtimi i ndasive në bazë të gjuhës gjatë pjesëmarrjes në tregun e punës (dokument i politikave)

Formula financiare për arsimin e lartë
- Analizë nga vlerësimi i buxhetit për hulumtim (3)
- Projekt për zhvillimin e mësimdhënësve (5)
- Politikat ANTI-korrupsion dhe analiza e praktikave (3)
- Raport nga analiza e proporcionit - student/staf (3)



Fasilitatorët: Bardha Qirezi, RIINVEST
dhe Mevlyde Hyseni, FES, Agnesa Qerimi, procesmbajtëse



Dhoma e Mendimit 2:

AKTIVIZMI QYTETAR PËR QEVERISJE TË MIRË

Fasilituar nga **Besa Kabashi-Ramaj,FES**
Jetmir Bakija (Demokracia +)

Pjesëmarrësit **(20) identifikuan sfidat e lidhura me këtë fushë:**

- **Luftimi i klientelizmit;**
- **Rrritja e qasjes në informacion;**
- **Forcimi i rolit të arsimit në ngritjen e aktivizmit qytetar;**
- **Adresimi i mungesës së stimulimeve (morale, materiale dhe institutionale) për të rinjtë dhe komunitetet për aktivizëm qytetar dhe vullnetarizëm.**

Megjithatë, këto sfida ishin identifikuar vetëm nga një grup i vogël i njerëzve, prandaj është e nevojshme të konsultohen qytetarët në komunitetet e shënjestruara për sfidat tjera të cilat mund të jenë të rëndësishme dhe ata të mobilizohen për të trajtuar këto çështje përmes mekanizmave dhe proceseve të duhura.
Çështje madhore për sa i përket procesit të hartimit të politikave publike në Kosovë është se qytetarët dhe palët me interes janë lënë jashtë këtij procesi. Kjo ndikon në implementimin dhe marrjen e këtyre politikave nga publiku, prandaj duke mos qenë aktiv në ngritjen e zërit të tyre gjatë një përpjekje për të tejkaluar sfidat me të cilat ata ballafaqohen në komunitetin e tyre. Shumica e qytetarëve nuk kanë as mjete për t'u informuar gjatë ndërmarrjes së proceseve të tilla.
Ndërtimi i aktivizmit qytetar duhet të filloj duke e rritur vetëdijesimin e qytetarëve për çështjet e lidhura me qeverisjen e mirë dhe duke i mobilizuar ata që të jenë pjesë e adresimit të sfidave të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në komunitetin e tyre.



Grupi për AQ dhe QM (Aktivizmi Qytetar dhe Qeverisja e Mirë) është njëri prej pesë grupeve të cilat veprojnë nën umbrellën e fushatës "Kosova që ne duam". Ndërsa, grupet tjera janë sektorale dhe fokusohen në politikat të cilat i nevoiten popullësisë së Kosovës. Qëllimi i këtij grupi është të ndërtojë aktivizmin qytetar për të shtyer përpara politikat publike dhe për të kërkuar në mënyrë aktive transparencë dhe llogaridhënie gjatë implementimit të këtyre politikave.

Interveninet e propozuara:

• Identifikimi i organizatave bazë në shtatë (7) komuna kryesore të cilat do të bashkëpunonin në organizimin e aktiviteteve të AQ dhe QM;
• Organizimi i aktiviteteve për Dialog në komunitet, në nivel qendror dhe atë lokal, me qëllim të ndërtimit të aktivizmit qytetar për qeverisje të mirë dhe gjetjen e çështjeve potenciale me rëndësi;
• Identifikimi i liderëve të komunitetit në mënyrë që ata të mobilizojnë komunitetin e tyre rreth çështjeve duke kërkuar vazhdimisht transparencë dhe llogaridhënie nga politikëbërësit publikë.
• Integrimi i autputeve nga Dialogu në komunitet për planifikimin e aktivitetit për Grupin AQ dhe QM për vitin e ardhshëm;
• Zhvillimi i mëtejm i platformës për AQ dhe QM;
• Dizajnimi dhe shtypja e platformave për t'u shpërndarë në komunitet;
• Plani i operimit për të inicuar implementimin e propozimeve të grupit.





Fasilitatorët: Besa Kabashi-Ramaj, FES
dhe Jetmir Bakija-Demokracia +


Schaubild 1
DenkraumArbeit Prozessgrafik
2014
2015
Konzeption & Konstitution
Auftakt & Kreativphase
Vertiefung & Finalisierung
Multiplikation & Ergebniskommunikation
Mai 2014
AUFTAKTKLAUSUR
AM MÜGGELSEE
Dezember 2014
FACHTAGUNG
REGELMÄSSIGE AG-SITZUNGEN, THEMENPATEN TREFFEN UND EXTERNE IMPULSE
Themenpat_Innen
Beiträge in überregionalen Medien
www.denkraumarbeit.de
IMPULSPAPIERE
ERARBEITUNG INTERNER GRUPPENPAPIERE
10 MÜGGELSEER THESEN
4 POSITIONSPAPIERE
SOVA QË NE DUAM
E KOSOVO WE WANT

Dhoma e Mendimit 3:

ZHVILLIMI EKONOMIK DHE KRIJIMI I VENDEVE TË PUNËS

Fasilituar nga **Besa Luzha, FES**
dhe **Rinor Gjonbalaj, MDA**

Pjesëmarrësit: **(18)**

Një grup prej tetëmbëdhjetë pjesëmarrësve në dhomën e mendimit për zhvillimin ekonomik dhe krijim të vendeve të punës ishin përfshirë në një dialog të thellë me qëllim të identifikimit të çështjeve kyçe dhe të mundësive me të cilat ballafaqohet ky sektor. Fasilitatorët e grupit e kanë drejtuar sesionin drejt një diskutimi efektiv, i cili i ka theksuar rekomandimet lidhur me atë se si duhet të trajtohen çështjet ekonomike kryesore në Kosovë.

Çështjet e rishfaqura të cilat janë diskutuar nga pjesëmarrësit në dhomën e mendimit për zhvillim ekonomik dhe krijim të vendeve të punës ishin:

Mungesat në Tregun e punës

- Mungesa e informacionit për shkathtësitë dhe kualifikimet në tregun aktual të punës
- Shpërputhja mes sistemit arsimor the tregut të punës, që rezulton me punëtorë të pakualifikuar në tregun e punës
- Çështja e ikjes së trurit, ku fuqia punëtore e shkathtë po gjenë vende pune jashtë Kosovës, pra duke migruar në shtetet e Evropës

Intervenimet në politika

- Mungesa e të dhënave dhe e informacionit të disponueshëm në sektorin privat për prodhimin e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve
- Mungesa e bashkërendimit mes sektorit publik dhe atij privat për të identifikuar sektorët më konkurrues
- Mungesa e barrierave (d.m.th., kuotave) për mbrojtjen e kompanive private



Kufizimet e burimeve


• Ndërprerjet e energjisë elektrike, të cilat pengojnë potencialet e bizneseve për të prodhuar
• Mungesa e iniciativave për energji te ripërtritshme

REZULTATET NGA DISKUTIMI:

Diskutimi brainstorming i ka përvijuar disa nga çështjet ekonomike më urgjente në Kosovë. Si një vend me shkallën më të lartë të papunësisë dhe nivelin më të ulët të produktivitetit në Evropë, Kosova ballafaqohet me sfida të shumfishta në rrafshin e arsimit dhe integrimit të fuqisë së re punëtore në tregun e punës. Veç kësaj, Kosova e ka shkallën më të ulët të tregtisë me shtetet tjera anëtare të CEFTA-s, veçanërisht në kuptim të shkallës së eksportit.

Prandaj, të frymëzuar nga treguesit kryesor për prodhimtarinë dhe punën, dikutimi i drejtuar nga pjesëmarrësit e grupit për zhvillim ekonomik dhe krijim të vendeve të punës e ka nënvizuar nevojën për një vizion ekonomik më të qartë dhe një strategji për trajtimin e disa mikro dhe makro problemeve dhe mundësive. Për rrjedhojë, pjesëmarrësit kanë dalë me rekomandime për një studim të mëtejm të tregut me qëllim të identifikimit të sektorëve dhe intervenimeve të cilat do të mund të përmirësonin perspektivën ekonomike të Kosovës.

Kështu, duhet të ndërmerren një numër hapash konkret për të bërë një studim për vlerësimin e konkurrueshmërisë, i cili do të vlerësonte konkurrueshmërinë e nënsektorëve në Kosovë, me fokus të veçant në industritë të cilat kanë potencial për të rritur numrin e punëtorëve, shitjen, rritjen e eksportit, dhe të treguesëve tjerë. Studimi për vlerësimin e konkurrueshmërisë do të zbulonte pesë nënsektorë dhe do të identifikonte tri intervenimet kryesore të nevojshme për secilin nënsektor.



AKTIVITETET E PROPOZUARA, PARTNERËT, DHE KORNIZA KOHORE

Aktivitetet e propozuara për krijimin e vlerësimit të konkurrueshmërisë së përmendur më lart, do të ishin:

Faza e hulumtimit
• Mbledhja e informacionit dhe hulumtimi i tregut
• Takimi me palët me interes
Faza e krijimit të strategjisë
• Krijimi i planit të veprimit
Faza e avokimit
• Shpërndarja nëpër medie sociale e blog-postimeve, infografikës, etj.







Fasilitatorët: Besa Luzha, FES dhe Rinor Gjonbalaj, MDA

KOSOVA
që duam we want Koje hoćemo
KOSOVA QË NE DUAM
KOSOVO
KOJE HOĆEMO
KOSOVA
Koje hoćemo
KOSOVA
we want
THE KOSOVO
WE WANT
FRIEDRICH EBERT STIFTUNG
KOSOVA
që duam
KOSOVA QE
NE DUAM
KOSOVA
we want
THE KOSOVO
WE WANT

Dhoma e Mendimit 4:

PUNË DHE JETË TË DINJITETSHME

Fasilituar nga **Alush Berisha, FES**
dhe **Jeton Mehmeti, GAP**

Pjesëmarrësit

Pjesëmarrësit e këtij grupi ishin nga sindikatat, Ministria e Punës, bizneset dhe OJQ-të të cilat punojnë në temat të cilat i adresojnë marrëdhëniet e punës, politikat sociale për të punësuarit, çështjet e shëndetit dhe të sigurisë në vendet e punës dhe fusha të tjera të lidhura. Të rinjtë kanë marrë pjesë në këtë grup, si dhe kishte pjesëmarrës ndërkombëtarë prej disa organizatave si UNICEF dhe UNDP.

Temat

Temat kryesore në këtë grup ishin përpjekja për ta definuar "dialogun social", nëse duhet të përfshij vetëm dialogun mes punëmarrësve dhe punëdhënësve në nivel nacional, sektoral dhe nivel të kompanive, ose nëse "dialogu social" duhet të shihet më gjerë dhe që përfshinë gjithë procesin e dialogut. Pas kësaj, tema kryesore e diskutimit ishte Dialogu Social - modeli në Kosovë, rezultatet e tij, sfidat dhe rruga përpara.





REZULTATET NGA DISKUTIMI

MODELI I DIALOGUT SOCIAL PËR NJË PUNË DHE JETË TË DINJITETSHME NË KOSOVË

Pas një debati të gjallë mes pjesëmarrësve, problemet e identifikuara kryesore ishin si vijon:

- Moszbatimi i Kontratës kolektive
- Moszbatimi i vendimit për pagën minimale nga ana e qeverisë
- Mosimplementimi i kontratave individuale të punës në sektorin privat
- Mungesa e dialogut social në nivel të kompanive
- Mungesa e dialogut në nivelin sektoral (përveç sektorëve në arsim dhe shëndetësi)
- Zhvillime jo transparente në Këshillin Ekonomik dhe Social (KES)
- Mungesa e debatit me grupet e interesit dhe me bazën përmes qasjes nga poshtë – lart
- Mungesa e përfshirjes së shoqërisë civile dhe medieve për shpjegime dhe monitorim të zhvillimeve në këtë fushë.
- Fragmentimi në sektorin e sindikatës dhe mungesa e sindikatës në sektorin privat.

Diskutimet rreth modelit të dialogut social për Kosovë:

• A është ky model i përshtatshëm për Kosovën?
• Roli i qeverisë në dialogun social
• A do të kufizohet dialogu vetëm në marrëdhëniet e punës?
• A duhet të zëvendësohet mungesa e sindikatave në sektorin privat me "Këshillat e Punëtorëve"?

Prioritetet tjera të dala nga diskutimi:

• Mundësitë e barabarta
• Pagat e barabarta
• Paga minimale e dinjitetshme
• Siguria për punë
• Informaliteti
• Amandamentimi i Ligjit të Punës (dispozita për pushimin e lehonisë, orari i punës, dhe çështje tjera të lidhura)
• Siguria dhe shëndeti në vendin e punës
• Siguria për shëndetin
• Ngacmimi seksual në vendin e punës
• Organizatat e sindikatave

Si të ndikohet për zbatimin efektiv të dispozitave ligjore tashmë të vendosura? Veçanërisht, dispozitat për pushimin e lehonisë dhe barazi gjinore janë vështirë të zbatueshme në këto rrethana ku rëndësia i është dhënë sektorit privat. Zbrazëtira e hulumtimit për adresimin e këtyre çështjeve duhet të plotësohet me iniciativa të partneritetit.


KOSOVA
we want
THE KOSOVO
WE WANT


Intervenimet e mundshme:

• Kontratat kolektive duhet të kompletohen nga fundi i këtij viti
• **Amandamentimi i Ligjit të Punës** (dispozita për pushimin e lehonisë, orari i punës, dhe çështje tjera të lidhura, Ligji për Këshillin Ekonomik dhe Social)
Debatet dhe sesionet e informimit për këto çështje duhet të jenë prioritet i kësaj "Dhome të Mendimit" gjatë javëve dhe muajve të ardhshëm.
Dispozita për pushimin e lehonisë të diskutohet për nga qasja e politikave sociale dhe perspektiva e mbrojtjes së fëmiut dhe familjes.
Kushtet e dinjitetshme të punës çojnë kah jeta e dinjitetshme për çdo qytetar të Kosovës dhe kjo duhet të jetë e arritur ambicioze e këtij grupi gjatë punës pas këtij kongresi.



Fasilitatorët: Jeton Mehmetaj, GAP dhe Alush Berisha, FES


KOSOVA





Dhoma e Mendimit 5:

SHËNDETI DHE POLITIKAT E MIRËQENIES SOCIALE

Fasilituar nga **Antoneta Coli, FES**
dhe **Florina Duli, IKS**
(nëngrupi Siguri Sociale)
Hana Xhemajli, FES & Ilir Hoxha,
Heimerer (nëngrupi Kujdesi Shëndetsor)

Pjesëmarrësit **(22) të ndarë në dy nëngrupe:**

a / Politikat e shëndetësisë
b / Politikat Sociale tjera

Çështjet kyçe në vazhdim kanë rezultuar nga grupi i parë i punës:

ORGANIZIMI

- LEGJISLACIONI KA NEVOJË PËR PËRMIRËSIME TË MËDHA
- ZBRAZËTIRA TË KONSIDERUESHME
- KRYESISHT PUBLIKE

QASJE E PËRGJITHSHME ndaj publikut

DISKUTIMET KYÇE

- PROBLEME ME MENAXHMENT DHE MANGËSI
- PROBLEME ME PLOTËSIM ME STAF DHE PUNËSIM
- SHËRBIME TË CILËSISË JOADEKUATE
- NEVOJA PËR ZHVILLIM TË VAZHDUESHËM PROFESIONAL DHE ARSIMIM
- MUNGESË E LLOGARIDHËNIES
- PAGA JO TË NJËJTA
- MUNGESA E MONITORIMIT TË DUHUR DHE E VLERËSIMIT
- PRIVACIA E PACIENTËVE



GRUPI PUNUES:

POLITIKAT SHËNDETËSORE

FOKUSI I TANISHËM:

- Sigurimi shëndetësor
- Mjekët e trajnuar migrojnë jashtë vendit
- Legjislacioni
- Cilësia e shërbimeve shëndetësore

Diskutime:

• Zhvillimi i strategjisë dhe qasja ndaj sigurimit shëndetësor
• Zhvillimi i strategjive specifike për tri prioritetet kryesore:
  o Arsimi shëndetësor,
  o Mjetet financiare/ financimi,
  o Riorganizimi/ reforma në sektorin e shëndetësisë dhe përmirësimet e nevojshme në menaxhim
• Ngritja e kapaciteteve menaxheriale për reformën në shëndetësi (ekspertët nga Banka Botërore kanë identifikuar mungesën e kapaciteteve menaxheriale për reformën në shëndetësi, hartim të politikave për institucionet shëndetësore).
• Zhvillimi i një fushate për sigurimin shëndetësor (promovim, informim, krijimi i doracakëve specifik për informim të qytetarëve përkitazi me sigurimin shëndetësor dhe çfarë rëndësie ka; çfarë pritet prej tyre në këtë drejtim; çfarë mbulohet me këtë sigurim dhe si do të kontribuojnë/financojnë atë qytetarët).
• Ofrimi i mundësive për arsimim të mëtejmë dhe vlerësim të stafit të sektorit të shëndetësisë, në përgjithësi përmes programeve, seminareve, kurseve të ndryshme dhe specializimeve (master), në mënyrë që të ketë një balancë mes komponentës teorike dhe asaj praktike.
• Zhvillimi i Shërbimeve Emergjente Nacionale (EMS), diagnostifikimi dhe protokollet e trajtimit sipas simptomave të shfaqura nga pacienti.
• Zhvillimi i sistemit të financimit në shëndetësi sipas modelit të solidaritetit për fondin e sigurimit shëndetësor (modeli i solidaritetit sipas të cilit secili qytetar është kontribuues ose paguan përmes primeve) për të pasur shërbime cilësore dhe që qytetarët të mos ngarkohen më financiarisht.
• Funksionalizimi i Spitalit Rajonal të Prishtinës dhe atij në Prizren, me theks në ofrimin e shërbimeve për qytetarët e mjediseve rurale. Kështu, do të ketë më pak ngarkesë për qytetarët që të udhëtojnë më larg për të marrë shërbime mjekësore bazike.
• Mbështetja e shkollave të cilat janë të specializuara për fusha të ndryshme të sektorit shëndetësor, si hulumtimet shkencore dhe stafi i cili merret me statistika specifike dhe hulumtim të sëmundjeve infektive dhe parandalimin e tyre.

Projektet e mundshme për adresimin e çështjeve:

• Diskutime në tryeza të rrumbullakëta për çdo muaj me palët e interesit në fushën e kujdesit shëndetësor
• Dokumente të politikave për çështje specifike për rastet kur ka mungesë informacioni.
• Zhvillimi i fushatave informuese për publikun e gjerë lidhur me sektorin e shëndetësisë dhe sigurimin shëndetësor.
• Mbajtja e debateve publike për shëndetësinë (pyetje dhe përgjigje)

Projekt shtesë

Në fund të Kongresit të mbajtur në muajin maj, pas identifikimit të prioriteteve , grupi punues u pajtua që të përpilojë një listë të aktiviteteve të cilat kanë të me shëndetësinë preventive. Kjo për faktin se, afërsisht gjysma e popullsisë së Kosovës është e moshës nën 35 vjeç, dhe se ekziston një nevojë e cila është në rritje për promovimin e të jetuarit të shëndetshëm dhe të ushtrimeve fizike. Duke qenë kështu, më poshtë kemi paraqitur disa ide që do të shërbejnë vetëm si një model për referencat e ardhshme. Të jetuarit e shëndetshëm: çfarë do të thotë kjo për secilin person.

• Si mund të zvogëlojmë shpenzimet për kujdesin shëndetësor përmes programeve të cilat i vejnë njerëzit në lëvizje: fushatat me fokus në aktivitetet në ambiente të jashtme dhe edukim për ushqim të shëndetshëm.



Fasilitatorët: Ilir Hoxha, Heimerer dhe Hana Xhemajli, FES



POLITIKAT SOCIALE

Fokusi i tanishem:

- Pensione
- Skemat Sociale
- Familje dhe politika të tjera
- Një jetë më e mirë për grupet e margjinalizuara në shoqëri
- Strehimi Social
- Shërbimet Sociale

Çështjet kryesore:

- Çfarë shteti duam që të jetë Kosova? (Orientim ideologjik)
- A është sistemi pensional diskriminues (skemat e pensioneve kontribuese, përvoja e punës, kualifikimi);
- A kemi nevojë për reformë të sistemit pensional?
- A janë identifikuar të gjitha grupet e cenueshme dhe a janë vlerësuar nevojat e tyre?
- A ka dështuar tashmë decentralizimi i shërbimeve sociale?
- A kemi shërbime të mjaftueshme dhe adekuate për personat e moshuar (veç shtëpisë së pleqëve në Prishtinë dhe në disa komuna tjera). A është neglizhuar kjo kategori e shoqërisë nga ana e partive politike dhe nga qeveria sepse kjo kategori nuk u sjell vota?
- Sa kujdesemi për fëmijët në Kosovë, duke pasur parasysh se ata e përbëjnë 50% e shoqërisë?
- A gëzon mbrojtje sociale komuniteti LGBTI?
- Si duhet të reformohen politikat për pushimin e lehonisë dhe cili duhet të jetë qëllimi (shtimi i natalitetit, mbështetja e sektorit privat, apo diçka tjetër) ?
- Dhuna në familje, mbrojtja e viktimave
- Mungesa e vullnetit politik për krijimin e mbrojtjes sociale dhe shëndetësore/fondi i sigurimit (mospërfillja, frika nga krijimi i fondit?)
- A do të lirohet buxheti nga presionet nëse krijohet ky fond, dhe cilat shërbime do të mbulohen nga këto fonde
- Legjislacioni: moszbatimi i legjislacionit/moszbatimi në kontekstin e Kosovës

Sfidat e identifikuara dhe të prioritetizuara nga pjesëmarrësit :

- Krijimi i fondit për mbrojtjen sociale;
- Kujdesi për fëmijët /politikat kundër abuzimit
- Decentralizimi i shërbimeve sociale (MPMS)
- Ri-identifikimi i grupeve të mbrojtura sociale
- Pushimi lehonisë
- Strehimi social publik
- Barazia në shpërndarjen e buxhetit publik
- Politikat për prindë të vetëm
- Reforma e pensioneve

Fasilitatorët: Florina Duli, IKS
& Antoneta Coli, FES




konomik
Jetë të Dinjitetshme
we wan
hoćemo


Ekonomski razv
Dostojanstven život I ra
we
emo


SHËNDETËSI
DHE MIRËQENIE


OSOVA QË NE DUAM
OSOVO KOJE HOĆEMO
HE KOSOVO WE WANT

KOSOVA
që duam / we want / koje hoćemo

FES KOSOVO TEAM



KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME PËR PUNËN E MËTEJSHME

Si rezultat I një procesi të gjatë konsultativ dhe reflektues mbi pakënaqësinë e shprehur të qytetarëve të Kosovës me situatën aktuale socio-ekonomike, lindi platforma Kosova që duam, e inicuar nga partnerët e shumtë të FES-it në shoqërinë civile. Synimi I kësaj platforme është që të nxisë një qytetari më aktive dhe të mirë informuar e të angazhuar politikisht në jetën publike, sidomos në sferat që prekin jetën e përditshme të qytetarëve.
Platforma synon të nxisë diskutime të mirë informuara dhe të orientuara drejt aksioneve konkrete për ndryshim në këto fusha: Arsim për Punësim dhe Zhvillim; Aktivizëm Qytetar për Qeverisje të Mirë; Zhvillim Ekonomik dhe Krijim të Vendeve të Punës; Dialog Social për Punë dhe Jetë të Dinjitetshme; Shëndetësi dhe Politika të Mirëqenies Sociale;
Kongresi i parë i iniciativës Kosova që duam u organizua si platformë nismëtare për të informuar partnerët për këtë iniciativë publike, reflektimin dhe të menduarit që solli deri te zhvillimi I saj dhe metodologjinë e punës në 5 "dhomat paralele të të menduarit ". Në kongres u vendosën rregullat për një diskutim dhe mendim reflektiv të përbashkët të orientuar kah zgjidhjet e problemeve të identifikuara nga pjesëmarrësit. Arritja e konsesusit për prioritizimin e çështjeve në secilën prej 5 dhomave paralele është parakisht për përcaktimin e aktiviteteve të përbashkëta për të krijuar zgjidhje për problematikat e identifikuara.
Vazhdimi I punës në 5 dhomat paralele të tëmenduarit do të jetë më kompleks në të ardhmen e me sfida shumë serioze.
· Rezultatet në të 5 fushat duhet të integrohen dhe ndërvarësia në mes tyre të vizualizohet qartë për të ndërtuar vizionin e modelit tështetit social e të mirëqenies në Kosovë, në përputhje me standardet minimale të modelit Evropian Ekonomik e Social, të përcaktuar në detaje në Acquis communautaire.
· Primesat e shtetit social duhet të kuptohen njësoj nga të gjtihë akterët-përmes analizës së problemeve, qëllimeve dhe ofrimit tëzgjidhjeve të mundshme së bashku dhe për të gjitha grupet e shoqërisë.Këto primesa duhet të komunikohen qartë në mënyrë që qytetarët ti identifikojnë lehtë dhe ti kërkojnë me ngulm nga subjektet politike që garojnë për votën e qytetarëve në proceset zgjedhore.
· Zhvillimi i presionit në debatin politik dhe pubik duhet të bëhet përmes një zëri unik dhe të fuqishëm që del nga aktivitetet e përbashkëta në nivel lokal dhe nacional.
· Ndryshimi i agjendës politike - vendosja e nevojave të qytetarëve dhe interest publik si prioritet
· Derisa kongresi prodhoi ide dhe interesim për pjesëmarrje në këtë proces nga grupet e ndryshme të shoqërisë civile, partitë politike dhe përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme, ky është vetëm fillimi i një rrugëtimi të gjatë drejt cakut, që është një lëvizje shoqërore active e e vetëqëndrueshme që ka informacioni të duhur, prioritizon cështjet me interes publik dhe bën presion për ndryshim-brenda dhe jashtë sistemit, me të vetmin qëllim-mbrojtjen e interesave të qytetarëvë të Kosovës. Çdo qytetar dhe organizatë e shoqërisë civile në Kosovë, që pajtohet me synimet e kësaj platforme, është i ftuar ti bashkohet asaj në cdo fazë të punës tash dhe në të ardhmen. Na duhet kontributi i secilit prej jush për të punuar së bashku për Kosovën që Duam.

NE DUAM:

• Sistem të kujdesit shëndetësor për të gjithë qytetarët – të përballueshëm dhe efikas.
• Sistem të arsimit modern – të lidhur me botën e punës dhe zhvillimin ekonomik.
• Standard minimal, por të denjë të sigurisë sociale për të gjithë qytetarët – sipas standardeve të BE-së.
• Zhvillim ekonomik të qëndrueshëm – të ndërtuar nga shkathtësitë dhe ndërmarrësia
• Kornizë demokratike për pjesëmarrje efektive dhe gjithëpërfshirëse të qytetarëve në nivelin qendror dhe atë lokal.



PJESËMARRËSIT



PJESËMARRËSIT // UČESNICI

ABEDIN SELIMAJ, IKSN

AFËRDITA ADEMI – LUX DEX

AFËRDITA HASANI – RIINVEST

AGNESA QERIMI – KYC

AGNETA BYTYQI – KOSOVO WOMEN 4 WOMEN

AHMET RUSHITI – KDI

AJETE KËRQELI – D4D

ALBANA GASHI – KOLEGJI RIINVEST

ALBANË TALLA – LAD

ALBERTA ALIHAJDARI – GIZ

ALBNORA GORELLI – UDHËHEQËSE RINVEST

ALBULENA BYTYQI – RADIO KOSOVA

ALBULENA SINANAJ – MDA

ALTINA XHINI – INJECT

ALUSH SEJDIU – SPRCK

ANASTASIA JOHANSSON – EMO

ANTIGONA MEHMETI

ARBEN DERMAKU – KËSHILLTAR MASHT

ARBEN KAÇANDOLLI – MDA

ARBEN QIREZI – PROFESOR

ARBEN THACI – PËRKTHYES

ARBËRIE NAGAVCI – LËVIZJA VETËVENDOSJE!

ARDIANA THACI – INSTITUTI COLUMBUS / KTV

ARDIT ALIJA- HANDIKOS- GJAKOVE

ARDIT GLLOGJANI – GWYA

ARDITA HAJRA – NGO AKTIV

ARIANA DAKA – REPORTERE

ARNESA LOXHA – KOEG

ARTAN MUSTAFA – LIGJËRUES NË UBT

ARTAN SADIKU – LUX DEVELOPMENT

ARTAN MUSTAFA – UBT

ASTRIT REXHAJ – BIZNISMEN

ATDHE HYKOLLI – BSPK

BARDHA QIREZI – RIINVEST

BARDHYL MUSA – MDA

BERAT RUKIQI – OEK

BERNARD TEHREBEGOLLI – KOLEGJI “HEIMERER”

BESA ÇARKAXHIU BIBAJ – NISMA ZHVILLOHU

BESA LUCI – K2.0

BESA LUZHA – FES

BESIM DOBRUNA – INSTITUTI EKOLOGJIK

BESIM MUSTAFA – OEK

BETIME HOXHA – IKS

BLEONA HUMOLLI – KOEG

BLERIM SYLA – FSSHK

BLERTA AVDIU – LUX DEV

BLERTA BERISHA – FSSHK

PJESËMARRËSIT // UČESNICI

BLERTA FETAHAJ – SHPRK

BLERTON JAKUPI – KOLEGJI “HEIMERER”

BOIKEN ABAZI – LËVIZJA VETËVENDOSJE!

BRIKENA HOXHA – IKS

BURIM MEHMETI - BIZNISMEN

CHUNNY YAN – UN

DARDAN SEJDIU – PSD

DARDAN SELIMAJ – COLUMBUS

DEBORA PECI – D+

DIANA LEKAJ- RIINVEST

DITA DOBRANJA – RIINVEST

DOMINIK DRASNAR – OSCE

DONAD DODI – IKS

DRAGOS MIKELI – KFOR

DRENUSHË ISUFI – KOMUNA E PRISHTINËS

DRITA HAJDINI - MPMS

DRITAN KËRCAGU – NIRVANA

DRITON TAFALLARI – DEVELOPING TOGETHER

DRITON ZHUBI – LENS

DUKAGJIN PUPOVCI – KEC

DHURATA PROKSHI – AKTIVISTE

EDI KUÇI – KYC

EDITA BAJRAMI – MPMS

EMA RACI- KEC,

ENGJËLL UKSHINI – NTS

ENKELEJDA ALIU – UNKT

ERLINDA ARDIMETAJ – YMCA IN KOSOVO

ERMIRA BERISHA – RIINVEST

EUGEN CAKOLLI - KDI

FATIR BERZATI – GORA REGION

FATMIR BYTYCI- KESHILLTAR POLITIK I MINISTRIT TE ARSIMIT

FATMIRE KOLLÇAKU – LËVIZJA VETEVËNDOSJE!

FERID TELIQI – PËRKTHYES

FITORE AJETI – MZHE

FITORE GJATA – SHPRK

FJOLLA MUÇAJ – STUDENTE

FJOLLA RAMADANI – KOSOVO EXPERTS GROUP

FLORIM GALLAPENI- HEIMERER COLLEGE:

FLORINA UJUPI – NISMA ZHVILLOHU

GRESA SMOLICA – LËVIZJA FOL

GËZIM XËRXA – INSPEKTORATI I PUNËS

HAJRULLAH MUSTAFA – ASHCM

HAMIT QERIQI – MDA

HANA GASHI – SHKOLLA DIGJITALE

HANA XHEMAJLI – FES

HANS SHAD KIM – UNDP

IBRAHIM REXHEPI – MZHE

ILIR HOXHA – SOLIDAR

ILIR JAKUPI – PËRKTHYES

ILIRJANA BAJRAKTARI – UGMCD

PJESËMARRËSIT // UČESNICI

ISAK SHEMA – KOLEGJI “ILIRIA”

JEHONA XHAFERI – KEC

JETA KRASNIQI – KDI

JETMIR BAKIJA – DEMOCRACY PLUS

JETON MEHMETI – GAP

JULIAN – KFOR

JUSUF AZEMI – SPSK

KIM HAES SHAL – UNDP

KRESHNIK AHMETI – LËVIZJA VETËVENDOSJE!

KRISTINA ZIMAJ – ANIBAR

KUSHTRIM BAJRAMI – KEC

KUSHTRIM SADIKU - GAZETAR

LAURA KRASNIQI – CIVI KOS

LEONA HUMOLLI- KOSOVA EXPERT GROUP

LEONORA AHMETI – MPMS

LEONORA LOKAJ – BSPK

LAURA KRYEZIU – LGC

LIBURNA MEHMETI – PROGRAMERE

LIS KOTORI – UNKT

LULZIM TAFA – REKTOR AAB

LUMNIJE AJDINI – AKB

LEUNORA AHMETI ZYLFIJAJ – MPMS

LUTFI BISLIMI – MPMS

LUTFI MANI – SBASHK

LULJETA ALIU – INJECT

MAJLINDA GJOCAJ – MSH

MARGARITA RASHITI – BIRN

MEJREME SHEMA – PENSIONERE

MERITA MRIPA - CDO

MEVLYDE HYSENI – FES

MIMOZA NAGAVCI – AIEX

MIRDITA BICAJ – AMB HUNGAREZE

MIRJETA ADEMI – KCSF

MIRJETA DURAKU - KOSOVAPRESS

MIRLINDA GOJANI – MOTHER TERESA

MUHAMED BAJRAMI – CET

MUHAMER IBRIQI – AGJENCIA
PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL

NASER GJONBALAJ – OMK

NAXHIT DELIQI – ISS INSTITUTE

NDUE KALAJ – SPAK

NGADHNJIM HALILAJ – D4D

NITA BAKALLI ISTREFI – KOORDINATORE

NITA - FORUMI KOSOVAR
I AFTËSISË SE KUFIZUAR

NITA RUDI – KDF

NORA JUSUFI – GAP

NORA LATIFI JASHARI – GAP

NORA MURATAJ – FSSHK

NORA ZHILIVODA – KAMA

NUHIJE AGUSHI – PARTNER KOSOVA

NURTEN DEMIRI – ELIO

ORGESTA HAJRIZI – D+

PJESËMARRËSIT // UČESNICI

OSMAN ABDULLAHU – PËRKTHYES

PYLLJON NURA – BÇ

QËNDRIM BYTYQI – LËVIZJA FOL

REIMONDA HOXHA – LGC

REMZI REKA – OMM GJETHI

RIDVAN GASHI – OJQ "MCK"

RINOR GJONBALAJ – MDA

RITA ISMAJLI – D+

RRAHMAN JASHARAJ – SBASHK

SADIJE SALIHU, INSTITUTI SHKENCOR KOSOVAR SUEDEZ;

SADRI RRMOKU – KLGI

SALIHE SALIHU – INSTITUTI SHKENCOR KOSOVARE – SUEDEZ

SAMEDIN MEHMETI – POLICIA E KOSOVES

SAMIJE GASHI – IKS

SANIJE XHEMAJLI – MSH

SARAH TENUS - UNKT

SELATIN KAÇANIKU – KONSUMATORI

SELATIN KLLOKOQI – INDEP

SHEMSI DREJTA - TEKNIK

SHPEND QAMILI – UNKT

SHPETIM MAVRAJ – KYC

SHPRESA MEHMETI – MASHT

SHPRESË QAMILI – UNIVERSITETI KADRI ZEKA

SHUKRIJE GASHI – PARTNERS KOSOVA

SHUKRIJE RAMA – ZSC JURIDIKA

SKORD RETKOCERI – KOSOVO EXPERTS GROUP

SYLEJMAN META - KRYETAR I FEDERATËS SË SINDIKATËS SË PENSIONISTËVE DHE INVALIDËVE TË PUNËS

TIME KADRIJAJ – DEPUTETE

TRINGA RAKA – OMM GJETHI

TRINGË SHKODRA – RIINVEST

UJKAN HYSAJ – AJO PICTURES

VALDET RAKA – OMM GJETHI

VALMIR ISMAJLI – D+

VALMIR XHEMAJLI – LENS

VEHBI GOXHUFI – GJEOMJEDISI

VEHBI MUJKU – DREJTOR I QENDRES PËR PUNË SOCIALE NË KOMUNËN E PRISHTINËS

VESA BARAKU XHEMA – TRAINING CENTRE

VESA IBRAHIMI – KQVR

VESA VUTHI – GWYA IN KOSOVO

VIOLETA DEMA – KABINETI I MINISTRISË SË ARSIMIT

VISAR YMERI – PSD

PJESËMARRËSIT // UČESNICI

VJOLLCA KARAKASHI – OEK

VJOLLCA SHALA – SBASHK

VLERA BAHTIRI – FES

VLORA BASHA BERISHA – INDEX KOSOVA

VULLNET KRASNIQI – KLAN KOSOVA

VUTH BISLIMI – MPMS

XHAFER HALITI – KOLEGJI FAMA, UNIONI STUDENTOR

XHEVDET GEGOLAJ – FONDACION

YLBER BEQIRI – MDA

YLLKA BUZHALA – LEVIZJA FOL

YLLKA KRASNIQI – FSSHK

ZANA RAMOVIC – KOEG


KOSOVA
që duam / we want / koje hocemo

KOSOVA
që duam

KONGRESI I PARË NACIONAL

“KOSOVA QË NE DUAM”

FRIEDRICH EBERT STIFTUNG
Büro Kosovo